



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

DREJTORIA E POLITIKAVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 6289 Prot.

Tiranë, më 28.9. 2022

Lënda: Dërgohet bashkëlidhur udhëzimi i Institutit të Shëndetit Publik

**ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR \_\_\_\_\_**

Ju dërgojmë bashkëlidhur për njohje dhe zbatim udhëzimin e Institutit të Shëndetit Publik nr. 309/4prot., datë 26.08.2022, “Mbi kujdesin dhe masat ndaj COVID-19 në institucionet arsimore për vitin 2022-2023 (i rishikuar Gusht 2022)”.

Duke ju falënderuar,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Alqi KUSHI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK

Nr. 309/4 prot.

Tiranë, më 26.08.2022

**U D H Ë Z I M**

**MBI KUJDESIN DHE MASAT NDAJ COVID-19 NË INSTITUCIONET ARSIMORE  
PËR VITIN 2022-2023**

*(I RISHIKUAR GUSHT 2022)*

**Hyrje**

Institucionet arsimore do të vijojnë procesin mësimor duke ndjekur dhe respektuar masat e kontrollit të infeksionit, higjienës personale dhe mjedisore me objektivin e mirëqënies dhe mbrojtjes së nxënësve/studentëve nga infeksioni me SARS-CoV-2 dhe nënvariantet e tij.

**COVID -19 vazhdon të qarkullojë në vend me intensitet të ndryshueshëm në komunitete të ndryshme, prandaj ky udhëzim do të përshtatet sipas situatës epidemiologjike dhe në vartësi të intensitetit të epidemisë në komunitete apo zona të ndryshme.**

**I. KUJDESI PËR NXËNËSIT/STUDENTËT DHE PËR MËSUESIT/PEDAGOGËT**

**Hyrja dhe dalja nga mjediset e institucioneve arsimore**

- Orari për hyrjen e nxënësve/studentëve në institucionet arsimore rregullohet sipas një grafiku, hartuar nga drejtorja e shkollës/administrata e institucionit arsimor nën monitorimin e mësuesve/pedagogëve.
- Dera e institucionit arsimor do të qëndrojë e mbyllur, ndërsa ajrosja e klasave/auditoreve do të kryehet herë pas here nëpërmjet dritareve.
- Hyrja dhe dalja e nxënësve/studentëve në institucionet arsimore kryhet duke zbatuar rregulloren e institucionit arsimor dhe duke zbatuar masat e kontrollit të infeksionit ndaj COVID19.
- Nxënësi/studenti që ka simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në institucionin arsimor, njofton mësuesin ose personin përgjegjës për çeshtjet shëndetësore paracaktuar nga drejtorja/administrata e institucionit arsimor, i cili, në bashkëpunim me mjekun e institucionit arsimor ose atë të familjes, verifikon nëse nxënësi/studenti është i

sëmurë apo jo. Justifikimi i mungesës bëhet vetëm nga mjeku pediatër apo mjeku i familjes.

#### **Qëndrimi dhe mësimi në institucionet arsimore (klasa/auditore)**

- Gjatë procesit mësimor, mësuesit/pedagogët dhe nxënësit/studentët respektojnë masat e kontrollit të infeksionit ndaj COVID19 sipas rekomandimeve të autoriteteve shëndetësore.
- Nëse transporti i nxënësve/studentëve kryhet me mjete të transportit të dedikuara ose publik, këto mjete duhet të respektojnë udhëzuesit për transportin publik.
- Institucionet arsimore duhet të marrin masa që të lejojnë ventilimin sa më të mirë të mjediseve të tyre.
- Personi përgjegjës për çeshtjet shëndetësore i institucionit arsimor dhe stafi mjekësor i shkollës (mjeku/infermierja e shkollës), përkatësisht në auditore vlerësojnë prezencën e studentëve dhe monitorojnë prezencën e nxënësve në shkollë mbi arsyet e mungesave çdo ditë, si dhe respektimin e masave higjieno sanitare mjedisore dhe individuale.

#### **Lëvizjet në mjediset e brendshme të institucionit arsimor**

- Lëvizja e nxënësve/studentëve në klasa/auditore, laboratorë, palestra dhe nëpër korridore duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë që në çdo zonë të respektohen masat e kontrollit të infeksionit ndaj COVID -19.
- Nuk duhet do të përdoren sende personale të panevojshme për procesin mësimor.

#### **Kujdesi për higjienën**

- Nxënësit/studentet informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi situatën dhe për rëndësinë e masave.
- Nxënësve/studentëve duhet t'u paraqiten herë pas here mënyra praktike demonstrimi apo aktivitete për rregullat e higjienës, larjen e duarve, mënyrën e kollitjes, teshtitjes dhe mbajtjen e maskës.
- Institucioni arsimor duhet të sigurojë zbatimin e masave të higjienës dhe masat e kontrollit të infeksionit të rekomanduara nga autoritetet shëndetësore, në mjediset e tij.
- Klasat/auditoret duhet të ajrosen herë pas here.
- Klasat/auditoret duhet të kenë numrin përkatës të nxënësve në vartësi të sipërfaqeve të tyre.
- Nëse nxënësi/studenti manifeston gjëndje stresi dhe ankthi, ai i drejtohet shërbimit psiko-social të institucionit arsimor.
- Të vendosen postera në mjediset e institucionit arsimor, mbi masat e parandalimit të infeksionit COVID-19, me mesazhe të qarta dhe të thjeshta, për mënyrën e larjes së duarve, higjienës personale, higjienës respiratore dhe mbajtjes së maskës.

## II. KUJDESI PËR PERSONELIN NDIHMËS

### Personeli sanitar

- Personelit sanitar u rekomandohet të mbajnë gjatë orarit të pastrimit maskën dhe të përdorin solucione pastrimi dhe dezinfektimi.
- Kryen të gjitha detyrat duke respektuar masat e higjienës në të gjitha mjediset e institucionit arsimor dhe masat e kontrollit të infeksionit të rekomanduara nga autoritetet shëndetësore.
- Dorezat e dyerve, dritareve dhe mjedisi punës që frekuentohet më shumë pastrohen me solucione pastrimi dhe dezinfektimi sa më shpesh.

### Roja i institucionit arsimor/oficeri i sigurisë

- Roja i institucionit arsimor/oficeri i sigurisë kryen të gjitha detyrat duke respektuar masat e kontrollit të infeksionit të rekomanduara nga autoritetet shëndetësore.

## III. KUJDESI PËR PRINDIN

- Nënshkruan ose konfirmon në rrugë elektronike tek mësuesi/mësuesi kujdestar apo pedagogu këtë rregullore.
- Plotëson formularin e vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore të fëmijes në rastet kur fëmija paraqet shenja të sëmundjes duke ja dorëzuar mësuesit kujdestar. (në rast të sistemit arsimor parauniversitar)
- Komunikim me mësuesin/pedagogun, mund të përdoret komunikimi elektronik dhe në rastet e planifikuara takimet ballë për ballë apo takimet me prindër (në rast të sistemit arsimor parauniversitar) sipas rregullores së institucionit arsimor.
- Prindi në rastet e shoqërimit të fëmijës/fëmijëve në institucionin arsimor, duhet të respektojë distancimin fizik dhe rregulloren e strukturës arsimore.
- Prindi merr pjesë në aktivitetet edukuese dhe informuese në lidhje me parandalimin, kontrollin e infeksionit dhe vaksinimin.

## IV. KUJDESI PËR DREJTUESIT

- Drejtuesit e institucionit arsimor duhet të ndjekin me rigorozitet udhëzimet e miratuara nga autoritetet shëndetësore.
- Për çdo nxënës/student i cili paraqet probleme shëndetësore, si p.sh rritje të temperaturës etj., apo ka njoftim nga prindi, ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID-19 dhe nëse prindi përkatës është i sëmurë apo ka patur kontakte me COVID-19 lajmëron menjëherë

sipas vendndodhjes së problemit shëndetësor mjekun e shkollës, mjekun e familjes dhe Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.

- Për çdo mësues/pedagog apo personel tjetër i institucionit arsimor i cili paraqet probleme shëndetësore si p.sh. rritje të temperaturës etj. apo ka njoftim se ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID-19 lajmëron menjëherë mjekun e institucionit arsimor, mjekun e familjes dhe Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.

#### V. Të përgjithshme

- Autoritetet shëndetësore vijojnë të rekomandojnë vendosjen e maskës për të minimizuar përhapjen e COVID 19 dhe nënvarianeteve të tij.
- Staf i në institucionet arsimore duhet të ketë kryer vaksinimin bazal dhe të vijoj dozat përforcuese ndaj COVID -19 sipas rekomandimeve të MSHMS.
- Çdo person që preket nga infeksioni SARS COV-2 ( testimi rezulton pozitiv) duhet të qëndrojë i izoluar deri në 5 ditë duke ndjekur rekomandimet nga mjeku pediatër apo mjeku i familjes dhe më pas mund të rikthehet në shkollë kur për 5 ditët pasuese ( deri në 10 ditë periudhë e plotë) duhet të mbajë maskë.
- Kontaktet e rasteve të konfirmuara me COVID-19 duhet të monitorohen gjatë të gjithë periudhës së inkubacionit duke respektuar masat e kontrollit të infeksionit.

*Instituti i Shëndetit Publik, rezervon të drejtën të rivlerësojë elementët e këtij udhëzuesi, në rast të ndryshimeve epidemiologjike të COVID-19.*

DREJTOR

EUGEN PETRINI

